



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:056480

Datë: 11.10.2024

Numri i dokumentit: 06288495

**A.nr.681/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative**, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me zyrtaren ligjore Asliha Fejzullahu, si procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditëses F. (M.) D. nga fshati R..., Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë-Departamenti i Pensioneve, të cilën sipas ligjit e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë, duke vendosur lidhur me padinë e paditëses për anulimin e vendimit me nr. të dosjes 6031874 i datës 08.01.2021, me kërkesë për pagesën e pensionit për personat me pa aftësi të përhershme, pas mbajtjes të seancës të shqyrtimit kryesor-publik, në prani të paditëses dhe në mungesë të përfaqësues ligjore të palës së paditur-Ministrisë së Drejtësisë-Avokaturës Shtetërore, me datë 02.10.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET NË TËRËSI E PA BAZUAR** kërkesëpadia e paditëses F. (M.) D. nga fshati R..., Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të” anulohet vendimi me nr. të dosjes 6031874 i datës 08.01.2021 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve dhe paditëses F. (M.) D. nga fshati R..., Komuna e Prizrenit i njihet e drejta në pension të pa aftësisë së përhershme për periudhë pesëvjeçare dhe nga data e nxjerrjes së vendimit të organit të shkallës së parë 22.09.2020 e deri me datë 21.09.2025, përkatësisht deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për njohjen e këtij pensioni, si dhe të detyrohet e paditura Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë-Departamenti i Pensioneve që paditëses F. (M.) D. nga fshati R..., Komuna e Prizrenit, në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme, t’ia paguaj në mënyrë retroaktive nga data 22.09.2020 shumën mujore prej 75€ deri me datë 31.12.2021, kurse nga data 01.01.2022, paditëses t’ia paguaj shumën mujore prej 100€, në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme deri me datë 21.09.2025, përkatësisht deri në ekzistimin e kushteve ligjore për njohjen e këtij pensioni”.
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e kontestuar me nr. të dosjes 6031874 i datës 08.01.2021, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e kontestuar, me datë 25.03.2021, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, me të cilën e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë-Departamenti i Pensioneve, siç kuptohet nga padia për shkak se nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe për shkak se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i datës 08.01.2021 i të paditurës MPMS-DP, si i paligjshëm dhe gjykata të miratoj vetë kërkesën e paditëses për njohjen e të drejtës në pension me pa aftësi të përhershme, dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës, si dhe të urdhërohet e paditura, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, të nxjerr aktvendim bazuar në këtë aktgjykim.

Tutje në padi është deklaruar se organi i shkallës së dytë ka nxjerr vendim arbitrar pa u lëshuar fare në vërtetimin e gjendjes faktike dhe shqyrtimin e provave të bashkangjitura. Ka cekur se ekzistojnë të gjitha provat, faktet dhe dëshmitë valide që të njihet e drejta në pension për persona me pa aftësi të përhershme, pasi që e njëjta në bazë të diagnozës mjekësore nuk është e aftë ti përgjigjet nevojave personale, është e sëmurë nga disa sëmundje dhe këtë fakt e dëshmon me raporte mjekësore të bashkangjitura. Ka vijuar se mos ekzaminimi i palës nga ana e komisioni mjekësor ka bërë që ndaj palës të krijohet parafytyrim i gabuar i gjendjes faktike, dhe se organi i shkallës së parë gabimisht i ka aplikuar dispozitat ligjore. Ka theksuar se organi i shkallës së dytë i ka injoruar të gjitha provat dhe dëshmitë dhe nuk e ka kontrolluar fare personin në fjalë dhe në aktvendimin e lëshuar nuk ka dhënë kurrfarë arsytimi, pse ato nuk janë marr fare parasysh, por vetëm me arsyetim të përgjithshëm se nuk ka dëshmi e ka refuzuar ankesën.

Përgjatë seancave gjyqësore, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare paditësja ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke e njoftuar gjykatën se e kam pranuar ekspertizën mjekësore dhe për të njëjtën nuk kam vërejtje, pasi që pajtohem me mendimin e paraqitur në ekspertizë.

Ka shtuar se pas dëgjimit të ekspertëve mjekësor konsideroj që u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë, andaj i propozoj gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin anulohet vendimi i MPMS-DP i datës 08.01.2021 dhe paditëses i njihet e drejta në pension të pa aftësisë së përhershme nga data e nxjerrjes së vendimit të shkallës së parë 22.09.2020, për periudhë 5 vjeçare, respektivisht deri me dt. 21.09.2025, si dhe të obligohet e paditura tani MFPT-DP që paditëses në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme nga data 22.09.2020, t'i a paguaj shumën mujore prej 75€ në muaj, deri me date 31.12.2021, kurse nga data 01.01.2022 paditëses t'ia paguaj shumën mujore prej 100€, në emër të pensionit të pa aftësisë së përhershme deri me dt. 21.09.2025, përkatësisht deri në ekzistimin e kushteve ligjore për njohjen e këtij pensionit.

Përfaqësuesja ligjore e të paditurës, Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore nga shkresat e lëndës rezulton se edhe pse e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi të gjykatës, nuk ka paraqitur përgjigje në padi dhe gjykatës nuk i ka dorëzuar shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me këtë çështje administrative.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 02.10.2024, ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor nenit 41 të LKA-së, në mungesë të përfaqësues ligjore të paditurës-Ministrisë së Drejtësisë-Avokaturës Shtetërore e cila kishte qenë e ftuar në mënyrë të rregullt për seancën, mirëpo askush nuk ka prezantuar dhe mos ardhjen në seancë nuk e ka arsyetuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 02.10.2024, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat relevante dhe atë: Vendimin e MPMS-DP të dt.08.01.2021, Raportet mjekësore për paditësen në shkresat e lëndës të dt.18.02.2021, 16.02.2021, 11.02.2021, 15.02.2021, 22.02.2021, 22.07.2024, 23.07.2024, 13.06.2024, 18.06.2024, 28.05.2024, 27.05.2024, 21.05.2024, 20.05.2024, 18.04.2024, 07.05.2024, 22.12.2023, 30.04.2024, Ekspertizën mjekësore të dt.11.09.2024.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 44 të LKA-së, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar, për këto arsye:

Nga provat shkresore të administruara në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ, gjykata ka konstatuar që e paditura në shkallë të dytë përmes Këshillit të Ankesave, me vendimin e kontestuar me nr. të dosjes 6031874 i datës 08.01.2021 i ka refuzuar paditëses ankesën të parashtruar kundër vendimit të organit të shkallës së parë të datës 22.09.2020, me të cilin vendim paditëses i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme. E paditura në vendimin e kontestuar ka theksuar se Këshilli i Ankesave si organ i shkallës së dytë, me ekspert mjekësor të lëmisë përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së znj. F. D., ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e datës 28.12.2020, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit të shkallës së parë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 të PAK, dhe ka konstatuar-vlerësuar se nuk ka dokumentacion mjekësor të mjaftueshëm për të qenë përfitues i pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, prandaj Komisioni Mjekësor i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejt dhe të saktë të gjendjes faktike në këtë konflikt administrativ, respektivisht mbi gjendjen shëndetësore të paditësit, gjykata në seancën gjyqësore të datës 12.12.2023, ka aprovuar propozimin e paditëses për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, kurse me aktvendimin e datës 10.01.2024 të nxjerr jashtë seancë ka caktuar ekspertët mjekësor Dr.T. I. H.-Gjinekologe Obstetër, Dr.A. G.-Psikiatër dhe Dr.Q. R.-Speciliste e Mjekësisë së Punës, për ta kryer ekspertizën mjekësore në këtë konflikt administrativ, përkatësisht që bazuar në dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejt të paditëses nëse tek paditësja ekziston pa aftësia e përhershme dhe e plotë për punë. Mjekët specialist të caktuar nga gjykata në ekspertizën mjekësore dorëzuar gjykatës të datës 11.09.2024, pas analizimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe ekzaminimin e drejtpërdrejt të paditëses kanë dhënë mendimin profesional sipas të cilit paditësja në gjendjen e tanishme nuk është e aftë të kryej punët që i detyrohen në shtëpi si amvise (ngritja e peshave, bartja e peshave, përkulja e shpeshtë, ecja e gjatë dhe ngritja në lartësi). Kjo periudhë korrespondon me gjendjen e tillë derisa nuk realizohet ndërhyrja operative e propozuar nga ana e neurokirurgut (operacioni i diskut ndërmjet unazave) dhe më pas të caktohet saktësisht shkalla e pa aftësisë së plotë për punë.

Ekspertja mjekësore Dr.T. I. H.-Gjinekologe Obstetër, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesim në tërësi pran mendimit të paraqitur në ekspertizë mjekësore e cila i është dorëzuar gjykatës, duke theksuar se konsideroj që në rastin konkret me kompetente për të dhënë sqarime në lidhje me ekspertizën dhe mendimin e ekspertizës është ekspertja specialiste e mjekësisë së punës. Ka shtuar se sa i përket aspektit gjinekologjik, konsideroj se kjo nuk ndërlihdhet për pa aftësi të përhershme ose të plotë për punë.

Ekspertja mjekësore Dr. A. G.-Psikiatër, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se po ashtu edhe nga aspekti psikiatrik, gjatë ekzaminimit të pacientes, këtu paditëses është konstatuar se e njëjta vuan nga çrregullimi anksio-depresiv, i cili nuk i plotëson kriteret për pa aftësi të përhershme për punë.

Ekspertja mjekësore Dr. Q. R.-Specialiste e Mjekësisë së Punës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mendimi im është i bazuar në ankesat, dhimbjet e kurrizit dhe unë i referohem raporteve të neurokirurgut dhe pas ekzaminimit të drejt për drejt të saj, duke u bazuar në profesionin e paditëses, përgatitjen profesionale, paditësja nuk kryen ndonjë pune tjetër vetëm si amvise, e me konkretisht në raportin e neurokirurgut rezulton se “paditësja ka diskut hernie” dhe kjo aktualisht deri në kryerjen e intervenimit mjekësor për këtë diagnozë që e ka, nuk mund ti kryej punët e shtëpisë që kërkojnë ngritje,

bartje e peshave, ecje përkulje e shpeshtë dhe ngjitje e shkalleve. Sipas saj ky mendim ipet deri në intervenimin kirurgjikal që mund ta këtë paditësja.

Ekspertja mjekësore në pyetjen e gjykatës se bazuar në dokumentacionin mjekësor të cilin e keni pasur në shqyrtim për paditësen gjendja aktuale e paditëses a ka qenë e njëjtë nga periudha e vitit 2020, ekspertja Specialiste e Mjekësisë së Punës është përgjigjur se paditësja me ankesat e saj sa i përket gjendjes shëndetësore ka filluar nga viti 2020, por sëmundja ka progredu dhe ankesat kane qenë me te mëdha me kalimin e kohës dhe se pas analizave dhe incizimeve të bëra, neurokirurgu ka konstatuar që paditësja duhet ti nënshtrohet intervenimit kirurgjikal.

Gjykata këtë ekspertizë mjekësore e mori si të besueshme, për arsye se, e njëjta ishte profesionale, e argumentuar mirë sipas vëllimit të përcaktuar, për vërtetimin e fakteve vendimtare me rëndësi në këtë konflikt administrativ, mirëpo gjykata vlerëson se përkundër konstatimit të ekspertizës mjekësore, në rastin konkret nuk është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë.

Në nenin 3 par.1 pika 1.6 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti është paraparë “1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.6. Pensioni i pa aftësisë të përhershme - pensioni i rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj”. Në vazhdim në nenin 9 të këtij ligji përcaktohet “1. Pensioni i paaftësisë të përhershme do t’iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

2. Pensioni i paaftësisë së përhershme do t’iu paguhet të gjithë atyre personave që janë shtetas të Republikës së Kosovës, që posedojnë dokumentet e identifikimit dhe të cilët i kanë tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç.

3. Kërkesa për pension të paaftësisë së përhershme, duhet të parashtrohet në organet përkatëse të Ministrisë, të cilat janë të instaluar në Komunitatet e Kosovës.

4. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisionet Mjekësore, në Qendrat Rajonale të Administratës Pensionale.

5. Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse:

5.1. ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore;

5.2. Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës;

5.3. Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh;

5.4. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nënparagrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor.

6 Ministria apo Autoriteti përkatës mund t’i autorizojnë zyrtarët përgjegjës për inspektime të rastësishme apo sistematike të personave, të cilat marrin pensionin e paaftësisë së përhershme, me qëllim të verifikimit të fakteve të dhëna në kërkesë dhe vazhdimësisë së përzgjedhjes për shfrytëzimin e pensionit të aftësisë së kufizuar.

7. Procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë të përhershme duhet të përmbajnë rregulla të përcaktuara me qëllim të mbrojtjes së informatave mjekësore konfidenciale të aplikuesve të cilat do të përcaktohen me akte nënligjore”. Në nenin 5 par.1 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimit për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme përcaktohet se “E drejta për të aplikuar për pension të pa aftësisë së përhershme, ushtrohet përmes kërkesës së palës, përkatësisht formularit përkatësisht formularit për aplikim në pension i cili duhet të përmbajë: 1.1 emërtimin e organit të cilit i drejtohet; 1.2 emrin e kërkuesit; 1.3 arsyen për njohjen e të së drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme; 1.4 datën e dorëzimit dhe 1.5 nënshkrimin”. Në paragrafin 2 të nenit 5 të këtij UA parashihet që “Kërkesës, duhet bashkëngjiten edhe këto dokumente si në vijim: 2.1 Dëshminë mjekësore

*se është me pa aftësi të përhershme; 2.2 Certifikatë apo raport mjekësor të lëshuar nga institucionet shëndetësore të nivelit sekondarë apo terciar. Në certifikatë duhet të jetë specifikuar vlerësimi i aftësisë së kufizuar, 2.3 Kopjen e dokumentit të identifikimit; 2.4 Ekstraktin nga Zyra Civile se është banor i përhershëm në adresën e caktuar; 2.5. Ekstraktin e lindjes; Një nga dëshmitë për faturat të cilat janë në emër të vet, faturën e tatimit në pronë, energjisë elektrike, ujit, mbeturinave, 2.7 Dëshmi tjera eventuale, të kërkuara nga zyrtari përgjegjës i zyrës pensionale përkatëse”. Në nenin 8 par.1, 2 dhe 3 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme thuhet se “ 1. Kërkesat për pension të paaftësisë së përhershme shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni Mjekësor i Departamentit të Pensioneve. 2. Komisioni Mjekësor, shqyrtimin e lëndës dhe ekzaminimet mjekësore i kryen në zyrat pensionale përkatëse. 3. Komisioni Mjekësor, në bazë të dëshmive mjekësore si dhe ekzaminimit të parashtruesit të kërkesës, vlerëson se e ekziston apo nuk ekziston paaftësia e përhershme tek parashtruesi i kërkesës”. Kurse në nenin 9 par.1 të UA të cekur më lartë përcaktohet se “Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit të pa aftësisë së përhershme i nënshtrohen procedurës së ri vlerësimi mjekësor pas skadimit të afatit të përcaktuar prej 1 (një), tre (3) apo pesë (5) vitesh”.*

Nga një gjendje e tillë e çështjes, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se, paditësja në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore, nuk ka arritur që me prova bindëse dhe të besueshme të dëshmoj se i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 9 paragrafi i Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe neni nenin 5 par.1 dhe 2 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme, për të qenë përfituese e pensionit të pa aftësisë së përhershme. Në këtë drejtim gjykata thekson se ekspertiza mjekësore e mjekëve specialist e datës e 11.09.2024, e ka konstatuar se paditësja në gjendjen e tanishme nuk është e aftë të kryej punët që i detyrohen në shtëpi si amvise (ngritja e peshave, bartja e peshave, përkulja e shpeshtë, ecja e gjatë dhe ngritja në lartësi), mirëpo ekspertiza mjekësore nuk ka dhënë konstatimin dhe mendimin profesional se paditësja gjendjen e njëjtë shëndetësore të cilën e ka aktualisht e ka pasur edhe në kohën kur ka paraqitur kërkesën për njohjen e të drejtës në pensionin e pa aftësisë së përhershme tek e paditura në vitin 2020, dhe në kohën kur ka paraqitur ankesë tek e paditura me datë 09.12.2020, ankesë kjo e cila është refuzuar me vendimin e kontestuar të datës 08.01.2021.

Gjykata nga shkresat e lëndës thekson se paditësja padisë i ka bashkangjitur raportet mjekësore të datave; 18.02.2021, 16.02.2021, 11.02.2021, 15.02.2021, 22.02.2021, 22.07.2024, 23.07.2024, 13.06.2024, 18.06.2024, 28.05.2024, 27.05.2024, 21.05.2024, 20.05.2024, 18.04.2024, 07.05.2024, 22.12.2023, 30.04.2024, mirëpo siç shihet nga këto data të gjitha këto raporte i përkasin periudhës kohore pasi që e paditura ka vendosur në shkallë të parë, për refuzimin e kërkesës së paditëses për njohjen e të drejtës në pensionin e pa aftësisë së përhershme dhe pasi që ka vendosur në shkallë të dytë me vendimin e kontestuar me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditëses, duke konfirmuar kësaj vendimin e organit të shkallës së parë.

Gjykata duke e pasur parasysh se bazuar në dispozitën e nenit 43 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr.03/L-202 është përcaktuar se “Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”, vlerëson në rastin konkret paditësja nuk ka arritur të argumentoj në këtë procedurë gjyqësore se me rastin e paraqitjes së kërkesës për pension të pa aftësisë së përhershme në procedurë administrative i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 9 paragrafi i Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe neni nenin 5 par.1 dhe 2 të UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme, për të qenë përfituese e pensionit të pa aftësisë së përhershme.

Gjykata vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i të paditurës është i ligjshëm dhe i drejtë, pasi që vendimi i kontestuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, në lidhje

me formën dhe elementet e detyrueshme të cilat duhet ti ketë akti administrativ dhe rregullat e procedurës, të cilat duhet të ndiqen për trajtimin e kërkesës për njohjen e të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme, e për të cilat shkaqe gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 44 par.2 të LKA-së. Vendimi i kontestuar i të paditurës është i qartë dhe i kuptueshëm. I njëjti përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar të paraparë me nenin 47 dhe 48 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Vendimi përmban hyrjen, pjesën urdhëruese-dispozitivin si dhe arsyetimin e vendimit. Në arsyetim janë paraqitur arsye të mjaftueshme për refuzimin e ankesës së paditëses, të cilat edhe gjykata i pranon, duke vlerësuar se edhe drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se e paditura e ka trajtuar ankesën e paditëses për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë së përhershme konform Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme, por që komisioni mjekësor i të paditurës pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor të paditëses në të dy shkallët, ka ardhur në përfundim se paditësja nuk i plotëson kriteret, për të qenë shfrytëzues i pensionit të pa aftësisë së përhershme

Gjykata konstaton se pensioni i pa aftësisë së përhershme në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, ju njihet personave të cilët janë plotësisht dhe përherë të pa aftë për çfarëdo lloji të punës në kohën e paraqitjes së kërkesës në procedurë administrative. Për më shumë gjykata thekson se paditësja në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante, me të cilën kishte me provuar pretendimin se tek e njëjta ka ekzistuar pa aftësia e përhershme dhe e plotë për punë në kohën e paraqitjes së kërkesës tek e paditura, ashtu siç kërkohet me nenin 9 par.5 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti dhe UA (MPMS) nr.06/2015 për Procedurat e Aplikimit dhe Vlerësimin për Pensionin e Paaftësisë së Përhershme.

Gjykata vlerëson se nuk ka bazë që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses në këtë rast bazuar në gjendjen shëndetësore të cilën e ka aktualisht paditësja, siç ka konstatuar ekspertiza mjekësore, sepse gjykata në procedurë të konfliktit administrativ shqyrton ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, i cili është nxjerr në procedurë administrative bazuar në faktet e vërtetuara në atë procedurë, prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Duke pasur parasysh të mësipërmen, kjo gjykatë konsaton se në këtë çështje administrative janë respektuar rregullat e procedurës administrative të cilat kanë pasur ndikim në vërtetimin e drejt të gjendjes faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses, andaj thënie e padisë nuk i aprovoj, sepse i vlerësoj pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura në procedurë administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.681/2021, datë 02.10.2024**

**G j y q t a r i**

Numri i lëndës: 2021:056480  
Datë: 11.10.2024  
Numri i dokumentit: 06288495

Rexhep Gashi

---

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.